



I nderuar Kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave z. Lumezi,

I nderuar Drejtor ekzekutiv i Shoqatës z. Balija,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve financiare,

Të nderuar pjesëmarrës,

Zonja dhe zotërinj,

Në emër të BQK-së, ju shpreh urimet për 20 vjetorin e themelimit të Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe ju falënderoj për bashkëpunimin gjatë këtyre viteve.

Si në gjithë botën, ashtu edhe në Kosovë, vitet e fundit kanë qenë mjaft sfiduese dhe të karakterizuara me një pasiguri të lartë, për sistemin financiar dhe për ekonominë e vendit. Si rezultat i kornizës rregullative adekuate si dhe standardeve të larta mbikëqyrëse, situata pandemike e gjeti sektorin bankar në Kosovë me nivele të larta të kapitalit dhe të likuiditetit, si dhe kualitet shumë të mirë të mjeteve.

Gjithashtu, masat e kujdesshme të ndërmarra nga BQK-ja në bashkëpunim me institucionet financiare që operojnë në Kosovë janë treguar shumë efektive në ruajtje të stabilitetit financiar dhe minimizimit të pasojave për ekonominë e vendit në përgjithësi.

Kjo qasje e kujdesshme dhe proaktive ka bërë që sektori bankar ta kalojë këtë periudhë mjaft të vështirë pa pësuar pasoja të rënda dhe sot kemi një sektor bankar, që në asnjë mënyrë nuk është bërë barrë e shtetit, përkundrazi është duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në kreditimin e ekonomisë dhe po shërben si një ndër shtyllat kryesore të stabilitetit dhe zhvillimit të ekonomisë së vendit.

Kreditimi bankar vazhdon të jetë një burim shumë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i financimit për ekonomitë familjare dhe bizneset në Kosovë. Sektori bankar, përkundër rreziqeve të rritura, ka vazhduar të rrisë kreditimin dhe të ruaj shkallën e qëndrueshmërisë. Vlera e kredive bankare deri në shtator 2022 ka arritur në 4.2 miliardë euro, duke shënuar një rritje të konsiderueshme vjetore prej 18.5%.

Presionet edhe ashtu të ngritura inflacioniste si rrjedhojë e zhvillimeve post-pandemike në ekonominë globale, tani po karakterizohen me një rritje të theksuar si pasojë e agresionit rus në Ukrainë. Presionet inflacioniste sigurisht se paraqesin sfidë edhe për stabilitetin financiar, duke qenë se ndikojnë drejtpërsëdrejti në aftësinë paguese të qytetarëve në kushtet kur të ardhurat nuk janë të korrigjuara për inflacionin.

Andaj, në këtë periudhë të tronditjeve gjeopolitike, veçanërisht duhet t'i kushtojmë vëmendje qëndrueshmërisë së sektorit bankar, si njëri ndër burimet kryesore të stabilitetit dhe rritjes së një ekonomie. Në Kosovë, fatmirësisht, kemi një sektor bankar me shkallë të lartë të qëndrueshmërisë, i cili ka aftësi t'i përballojë tronditjeve të mundshme negative dhej në të njëjtën kohë, të ndihmojë ekonominë të përballojë me pasoja minimale tronditjet e mundshme përmes financimit të qëndrueshëm.

Ndër sfidat kryesore në bankingun modern janë avancimi i bankingut dixhital dhe çështja e ndikimit mjedisor në sistemin bankar.

Gjatë viteve të fundit ka pasur një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të dixhitalizimit të shërbimeve financiare, i cili është duke e transformuar sistemin financiar. Procesin e transformimit digjital ne e shohim si një mundësi që institucionet financiare të bëhen më efikase, si dhe të përmirësojnë qasjen në shërbimet financiare për ekonomitë familjare dhe bizneset.

Sa i përket fushës së pagesave, BQK-ja ka bërë disa hapa të rëndësishëm në liberalizimin e tregut, ku pagesat dhe shërbimet e transfereve të parave janë lejuar të ofrohen edhe nga institucione financiare jobankare. BQK-ja ka planifikuar që të liberalizojë edhe më tutje tregun e shërbimeve të pagesave duke adoptuar direktivën e BE-së për shërbimet e pagesave të njohur si PSD2, si dhe dy direktivat e BE-së që adresojnë llogaritë e pagesave dhe paratë elektronike, në kuadër të ligjit të ri për shërbimet e pagesave.

Kjo kornizë ligjore do të lejojë një grup të larmishëm të ofruesve të shërbimeve të pagesave që të operojnë dhe të konkurrojnë në tregun e pagesave, duke ndihmuar gjithashtu në krijimin e pagesave lokale dhe ndërkufitare më efikase dhe më të përballueshme. Gjithashtu do të na përgatitë për përmbushjen e kushteve të aplikimit për anëtarësim në Skemën Evropiane të Pagesave të njohur si SEPA, si një nga synimet tona kryesore në të ardhmen. Ky kuadër ligjor do të vendos bazat për dekadën e ardhshme dhe do të sjellë konkurrencë më të theksuar në fushën e shërbimeve financiare dixhitale.

Është për t'u theksuar se bankat në Kosovë kanë qenë shumë proaktive në drejtim të ndërmarrjes së iniciativave dhe veprimeve për zhvillime të reja dhe përshtatje të

teknologjive më bashkëkohore, të krahasueshme me ato të vendeve të Evropës Perëndimore.

Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve financiare që rrjedhin nga ndryshimet klimatike është njëra nga sfidat me të cilat po përballen autoritetet mbikëqyrëse dhe sektori bankar.

Në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor edhe Kosova ka miratuar Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në Samitin e Sofjes, në nëntor 2020, e cila është një udhërrëfyes gjithëpërfshirës strategjik lidhur me ndryshimet klimatike. Kjo agjendë tregon rrugën drejtë zgjidhjeve të reja të energjisë, që nënkupton rritjen e investimeve në burime të ripërtëritshme, si dhe zhvillim të qëndrueshëm mjedisor.

Sektori bankar paraqet komponentin kryesor të sistemit financiar të Kosovës, kështu që bankat do të luajnë një rol të rëndësishëm në tranzicionin drejtë ekonomisë së gjelbër. Ndryshimet klimatike krijojnë rreziqe për bankat, andaj është detyra jonë të sigurojmë që bankat nën mbikëqyrjen tonë t'i adresojnë këto rreziqe në mënyrë adekuate dhe proaktive.

Si pjesë e angazhimit të BQK-së në avancimin e kësaj çështje, ne tashmë kemi aplikuar për t'u anëtarësuar në Rrjetin për Gjelbërimin e Sistemit Financiar, i cili është një rrjet prej 83 bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse financiare prestigjioze që synon të përshpejtojë rritjen e financave të gjelbra dhe të zhvillojë rekomandime për rolin e bankave qendrore për ndryshimet klimatike. Shpresojmë që së shpejti të bëhemi pjesë e këtij rrjeti prestigjioz të bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse financiare.

Gjithashtu në bashkëpunim me Bankën Botërore jemi duke e hartuar një strategji ku do të definohen rekomandimet dhe kërkesat mbikëqyrëse për menaxhimin e rreziqeve të lidhura me ndryshimet klimatike.

Si konkludim, gjatë kësaj periudhe delikate është shumë e rëndësishme që sektori bankar të vazhdojë të mbështesë ekonominë nëpërmjet kreditimit të saj. Gjithashtu duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë monitorimit të rreziqeve financiare, provizionimit adekuat, transparencës dhe sjelljes së përgjegjshme ndaj klientëve.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar që të sigurojë stabilitetin financiar dhe të mbështesë ekonominë e vendit me të gjitha instrumentet në dispozicion.

Duke ju përgëzuar edhe një herë për realizimin e konferencës së sotme, ju uroj punë të mbarë.

Faleminderit!